KËRKESË
Nr. 1032/6, datë 12.8.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për projektin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 317, datë 6.5.2026, të Këshillit të Ministrave, 'Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, 'Ndërtim rruga Kashar–nyja Vaqarr, fazat I dhe II'"".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit:

1."Truall", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

2. Ndërtesë "objekt banimi", përllogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 3,545,205 lekë (tre milionë e pesëqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e pesë) lekë.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I DREJTORISË SË NEGOCIMIT
DHE ASISTENCËS LIGJORE
Denada Dosti

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PROJEKTIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 317, DATË 6.5.2026, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT, ‘NDËRTIM RRUGA KASHAR–NYJA VAQARR, FAZAT I DHE II’””

	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)								“Truall”			“Ndërtesë banimi”			Ndërtesë “social-ekonomike”			Shuma totale	Shënime (seksioni C, D, E të kartelës së pasurisë)
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	“Truall” (m^2)	“Ndërtesë” (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera sipas preventivit (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
158	Dervish	Hysen	Gjoka	1017	36/1	Truall	154.5	154.5	51.5	3	136	154.5	490	75,705	51.5		3,469,500				,545,205	**E**. Vendimi nr. 1145, datë 18.6.2021, godinë banimi 1-kat, sip. kt. përdhe =51.5m^2.
SHUMA PARAPRAKE																					3,545,205	